

Observatori për të drejtat e Fëmijëve
Qarku Berat

Qarku i Beratit ka një popullsi prej 231.683 banorësh[1] dhe një numër total familjesh prej 61.439[2]. Qarku i Beratit përbëhet nga 25 njësi vendore nga të cilat 4 janë bashki dhe 21 janë komuna. Berati është një nga qendrat më të vjetra dhe më të rëndësishme të Shqipërisë me vlera të veçanta dhe vazhdimësi jetese të pandërprerë. Ai njihet si qendër e banuar ilire, qytet ilir, arbëror dhe se fundi shqiptar . Ndërtimet e kultit me monumentet më të rëndësishëm shquhen për arkitekturën e spikatur.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011
Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Qershor 2011)

Gjatë periudhës së tranzicionit qarku ka pësuar ndryshime thelbësore demografike. Populllsia është zvogëluar rreth 13.4% për shkak të migrimit jashtë dhe brenda vendit, duke e renditur Beratin të tretin në vend për nga zvogëlimi i numrit të banorëve në periudhën 1989-2001; rrethi i Skraparit renditet i pari në qarkun e Beratit.

Më shumë informacion rreth qarkut mund të gjeni në faqen: http://www.qarkuberat.net

Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Qarku i Beratit në vitin 2010, ka *231.683*[1] banorë dhe *61.439*[2] familje në total. Nga numri total i familjeve në qark, *3.905 familje (6.35%)* janë familje të varfra dhe kanë fëmijë (grupmosha 0-18 vjeç). Fëmijët (0-18 vjeç) përbën *27.3 % të populllsisë (63.342 fëmijë).*

Qarku i Beratit ka 753 fëmijë (0-18 vjeç) me aftësi të kufizuar. Bashkia Berat ka nën varësinë e saj dy qendra rezidenciale ''Lira'' dhe ''Unë jam si Ju''. Gjithashtu kjo bashki ka organizuar takime , trajnime me stafin dhe aktorët e tjerë lokalë për konventën dhe të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK).

Bazuar në të dhënat e marra nga shkollat, në Qarkun e Beratit janë rreth 57 fëmijë të cilët kanë braktisur shkollën gjatë vitit 2010-2011. Grupi i fëmijëve braktisës është kryesisht pjesë e komunitetit egjiptian, rom dhe komuniteteve ku problemet sociale janë të mëdha. Reduktimi i fenomenit të braktisjes së shkollës ka qenë një nga objektivat më të rëndësishme të DAR dhe është vlerësuar si e tillë dhe nga drejtoritë e shkollave, stafet mësimore dhe Qeveritë e Nxënësve. Vëmendja është përqendruar në ato shkolla ku ka fëmijë të komunitetit rom, si psh; shkolla “Sh.Lakra“, shkolla “Morave“, shkolla “5 Maji“, shkolla “Uznove“, shkolla “Hinke“. DAR ka monitoruar frekuentimin e tyre në arsimin parashkollor dhe 9-vjeçar, integrimin e tyre ne proçesin mësimor, punën e diferencuar edukative. Rreth *94* fëmijë rom nga *103* mbaruan vitin shkollor 2010-2011 dhe rreth *28* fëmijë të këtij komuniteti janë pjesë e arsimit parashkollor . Numri i populllsisë Rome në Qarkun e Beratit është i lartë dhe për këtë arsye janë marrë një sërë nismash në ndimë të këtij komuniteti.

1 Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011
2 Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)





Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur ne qarkun e Beratit në vitin 2011, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.

Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Berat gjendet në:

Sheshi Republika, Këshilli i Qarkut,
Berat, Shqipëri
e-mail: observatori_br@yahoo.com
URL: www.observator.org.al

Politika Rajonale në ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Qarku i Beratit aktualisht është në proçesin e hartimit të një plani rajonal veprimi për fëmijët, në përputhje edhe me planin kombëtar te veprimit për fëmijët, i cili do t'i bashkëngjitet strategjisë rajonale të zhvillimit të Qarkut Berat.

Numri i fëmijëve të regjistruar në Nivelet Parashkollor, Arsim i Detyruar dhe Të Mesëm për Rrethet Berat, Kuçovë dhe Skrapar (nga e majta në të djathtë)







Numri i fëmijëve 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar

Në dobi të realizimit dhe përmbushjes të të drejtave të fëmijëve, në Qarkun Berat, veç zyrës së Observatorit, është ngritur dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve" në Qark.













Shënim: Të dhënat "Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë",- janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.